



Nestor Topençarov

Bio e shkurtër

Nestor Topencharov (Nestor Topençarov) është një ndër të mbijetuarit e diktaturës komuniste në Shqipëri dhe ish-i burgosur politik. Ai njihet për dëshmitë e tij të fuqishme mbi persekutimin e egër që familja e tij pësoi nga regjimi dhe për mbijetesën në kampin famëkeq të Spaçit. Këto janë disa nga faktet kryesore rreth jetës dhe dëshmisë së tij: Persekutimi i Familjes: I lindur në Korçë, jeta e tij ndryshoi rrënjësisht në vitin 1976 kur Sigurimi i Shtetit arrestoi babanë e tij nën akuza të rreme si "agjent i jugosllavëve". Burgosja: Si student i bujqësisë, Nestorit iu kërkua të dëshmonte kundër babait të tij. Pasi refuzoi dhe duroi tortura të rënda, ai u dënua me 7 vite burg për "agjitacion dhe propagandë". Ai e vuajti dënimin në minierën e Spaçit. Kujtimet: Pas lirimit me amnistinë e vitit 1982, ai dokumentoi historinë tragjike të familjes së tij në librin "Drama e jetës" (Historia e një familjeje). Advokimi: Ai mbetet një zë aktiv në ndërgjegjësimin e publikut për krimet e komunizmit. Portreti i tij u përfshi edhe në ekspozitën "Udhëtime të papritura të jetës" në Tiranë, kushtuar të mbijetuarve të diktaturës.

Titulli: Nga emigrant jugosllav në “armik të popullit”: Historia e një familjeje nënurvejimin dhe represionin e Sigurimit të Shtetit.

Abstrakt

Jam djali i një emigranti jugosllav që jetoi në Shqipëri për 40 vjet.

Historinë e familjes sime e kam shkruar në disa libra, por këtu do të përqendrohem në temën që i intereson kësaj konference.

Babai im kaloi kufirin jugosllavo – shqiptar me një varkë nëpërmjet liqenit të Ohrit në qershor të vitit 1950. Arsyeja ishte, mbajtja e fjalës së dhënë të fejuarës, e cila jetonte në Shqipëri, për të krijuar një familje. Jemi në një periudhë shumë të vështirë të raporteve midis dy vendeve fqinje. Jugosllavia në vitin 1948 ishte përjashtuar nga kampi socialist. Në mënyrë legale ishte e pamundur

të hyjë në Shqipëri. Në mënyrë ilegale ishte shumë e rrezikshme. Me tregonte babai odisenë e tij të kalimit të liqenit natën, kur dallgët kishin mundësi ta kthenin përsëri nga ishte nisur. Në qoftë se do të kishte ndodhur kjo, do të kishte qenë një fund i hidhur për të, mbasi rojet jugosllave të bregut të liqenit kishin urdhër të qëllonin mbi këdo.

Kur arriti në fshatin Lin, u lajmërua Dega e P. Brendshme e Pogradecit e cila mori të gjitha të dhënat. Megjithëse çdo gjë u konfirmua nga ana e mamasë dhe familjes së saj, babai u internua në Llakatund të Vlorës ku ishin të gjithë emigrantët jugosllavë të ardhur në numrin më të madh nga Mali i Zi dhe Kosova. Pothuajse të gjithë ishin emigrantë politikë, të cilët ishin kundër politikës së Titos. Megjithatë shteti shqiptar i mbante në këtë qendër filtrimi ku Sigurimi kishte programet e tij.

Për gati 2 vite e gjysmë babanë e mbajtën në këtë qendër deri sa iu aprovua shtetësia shqiptare. Më pas në fillim të vitit 1953 erdhi transferimi i tij në Tiranë dhe martesë me gruan që donte. Gjatë periudhës që ishte në Llakatund, një prej punonjësve të Sigurimit i ishte afruar babait me propozimin për bashkëpunim, bile dhe me detyra për ta dërguar jashtë Shqipërisë, (në Jugosllavi). Përgjigja e babait ishte, se nuk merrte vesh nga politika dhe se në Shqipëri kishte ardhur mbasi kishte të fejuarën.

Kaluam mjaft vite të qeta në qytetin e Korçës ku familja ime ishte shpërngulur në vitin 1957.

Në vitet në vazhdim babai gjithmonë në mënyrë legale, drejtuar organeve kompetente shqiptare, kërkonte familjarisht riatdhesimin në vendin e tij të lindjes. Gjatë kësaj periudhe për mjaft emigrantë të tjerë në mënyrë të papritur, u jepej ultimatum të pregatisnin plaçkat brenda 24 orësh mbasi do të riatdhesoheshin. Kjo nuk ndodhi me familjen tonë. Babai u duhej për profesionin e tij të topografit. Puna e tij kishte qenë gjithmonë e vlerësuar kudo që kishte punuar. U arrestua në Prill të vitit 1976 mbasi mori pensionin e parë. Që nga ai moment kalvari i gjatë prej 14 vitesh do të vazhdote me arrestimin tim në tetor 1976 dhe mbas daljes nga burgu në nëntor 1982 do të ndiqeshim egërsisht nga regjimi diktatorial. Qëllimi i tyre kur na arrestuan ishte që të prananim që ishim agjentë jugosllavë, megjithëse nuk kishin asnjë fakt, por kjo nuk kishte rëndësi për ta. E rëndësishme ishte që unë dhe babai të prananim dhe të implikonim edhe emigrantë të tjerë jugosllavë. Kur nuk ia dolën, na dënuan për agjitacion e propagandë armiqësore. Babait, gjyqin ia bënë me dyer të mbyllura për dy arsye:

- E para, për 1 vit e gjysmë ishte bërë një propagandë e madhe në qytet, ku kishin kapur një agjent të rrezikshëm dhe këtë proces donin ta fshihnin nga publiku korçar.

- E dyta mbasi gjendja e babait ishte shumë e rëndë. Në hetuesi i kishin thyer disa brinjë e dëmtuar mushkërinë, dhe më pas nga kjo situatë kaloi në një gjendje depresive. Kaloi mbi 1 vit në spital.

Mbas burgut menduam se e gjitha mbaroi me kaq. Por nuk ishte kështu. Dosjet u hapën menjëherë dhe ish hetuesi ynë me kërkesën e Ministrisë së Brendshme mbas 6 vjetësh, në vitin 1983 shkruan një relacion me shpifje dhe gënjeshtër që një njeri i ndershëm nuk do t'i besonte kurrë. Një relacion që do të kishte koseguenca katastrofale për familjen time. Por kjo nuk i interesonte Ministrinë së Brendshme dhe Degës së Korçës. Ata përpiqeshin me çdo kusht për të krijuar këtë grup agentësh. Mendonin se babai i moshuar i vuajtur dhe i sëmurë do ta thyenin për të pranuar atë që donin ata.

Në vitin 1987 e mbyllën në një dhomë të Hotel Turizmit në Korçë duke përdorur edhe violencën fizike për ta detyruar. Por nuk ia arritën dot qëllimit.

Hapja e dosjes formulare të babait rezulton dy vjet para arrestit, megjithëse thuhet që ka qenë vazhdimisht i survejuar. Kjo dosje filloi të mbushet me deklarata nga dy emigrantë jugosllavë bashkëpunorë, të cilët vite më vonë edhe ata filluan t'i ndiqnin me dosje në 2A për agjenturë. Pra një fund i merituar. Në dosjet tona përmenden edhe mjaft emigrantë të tjerë njerëz me dinjitet, disa prej tyre të dënuar për agjitacion e propagandë dhe të tjerë të planifikuar për grupe agjenturiale.

Vetëm rënia e diktaturës mbylli edhe këtë faqe të hidhur.